

JON AUDITING sh.p.k

# Raport i Audituesit të Pavarur

Partia Socialiste e Shqipërisë

Margarita Kalemasi



2014

## Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	2
B. BILANCI KONTABËL.....	4
C. PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE .....	6
D. SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE.....	7-13

**Jon Auditing sh.p.k**

Rr. Asim Vokshi  
Nd. 14, H. 6, Ap. 27  
Kod Postar 1016  
Tiranë, Shqipëri

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

**Drejtuar: Partia Socialiste e Shqipërisë**  
Sheshi “Austria”

**Tiranë**

**Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve**  
Blvd. Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve,  
**Tiranë**

Të nderuar Zotërinj,

Bazuar në Ligjin 10019 datë 29/12/2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në zbatim të Vendimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Nr.15 datë 02.05.2014 si edhe Kontratën e shërbimit Nr. 645 datë 05.05.2014 të lidhur me këtë institucion në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar kemi audituar pasqyrat financiare të “Partia Socialiste e Shqipërisë”, që përfshijnë Bilancin Kontabël më 31.12.2013, Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për këtë ushtrimin, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël kryesore dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgatitja dhe paraqitja e sinqertë e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit është përgjegjësi e Drejtimit të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto Standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi përfshin ekzaminimin mbi bazën e testeve, të evidencës që mbështet shunat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë dhe vlerësimin e rrishtit të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre Vlerësimeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e

drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kryesore të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

**Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjendjen financiare të “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË” më datë 31 Dhjetor 2013 dhe të rezultatit të saj financiar për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Ligjin 8580 datë 17/02/2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar dhe Ligjin 9228 datë 29/04/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.**

Tiranë, më, 02.06.2014

**Për dhe në emër të “Jon Auditing” sh.p.k**

**Margarita KALEMASI**

**Eksperte Kontabël e Regjistruar**



**Pasqyrat Financiare**
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013**
**PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË**
**(Të gjitha balancat janë në leke)**

A AKTIVI	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2013	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2012	Ndryshimi
<b>I AKTIVET AFATSHKURTRA</b>			
<b>1 Aktive monetare</b>	1,691,970	1,194,245	497,725
2 Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim	-	-	-
(i) Derivativët	-	-	-
(ii) Aktivët e mbajtura për tregtim	-	-	-
<b>Totali 2</b>	1,691,970	1,194,245	497,725
<b>3 Aktive të tjera financiare afatshkurtra</b>			-
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	1,090,000	-	1,090,000
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	109,309	-	109,309
(iii) Instrumente të tjera borxhi	2,624,720	-	2,624,720
(iv) Investime të tjera financiare	-	-	-
<b>Totali 3</b>	3,824,029	-	3,824,029
<b>4 Inventari</b>			-
(i) Lëndët e para	-	-	-
(ii) Prodhim në proces	-	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-	-
(iv) Te tjera ne perdoim	1,420,743	673,953	746,790
(v) Parapagesat për furnizime	-	-	-
<b>Totali 4</b>	1,420,743	673,953	746,790
<b>5 Aktivët biologjike afatshkurtra</b>	-	-	-
<b>6 Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje</b>	-	-	-
<b>7 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra</b>	-	-	-
<b>TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)</b>	<b>6,936,742</b>	<b>1,868,198</b>	<b>5,068,544</b>
<b>II AKTIVET AFATGJATA</b>			
<b>1 Investimet financiare afatgjata</b>			-
(i) Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara	-	-	-
(ii) Aksione dhe investime të tjera në pjesëmar	-	-	-
(iii) Aksione dhe letra të tjera me vlerë	-	-	-
(iv) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata	-	-	-
<b>Totali 1.</b>	-	-	-
<b>2 Aktive afatgjata materiale</b>			
(i) Toka	-	-	-
(ii) Ndërtesa	1,643,389	1,643,389	-
(iii) Makineri dhe pajisje	9,631,554	8,940,815	690,739
(iv) Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.ko	217,420	217,420	-
<b>Totali 2</b>	<b>11,492,363</b>	<b>10,801,624</b>	<b>690,739</b>
<b>3 Aktivët Biologjike afatgjata</b>	-	-	-
<b>4 Aktivët afatgjata jomateriale</b>			
(i) Emri i mirë	-	-	-
(ii) Shpenzimet e zhvillimit	-	-	-
(iii) Aktive të tjera afatgjata jomateriale	-	-	-
<b>Totali 4</b>	-	-	-
<b>5 Kapital aksionar i papaguar</b>	-	-	-
<b>6 Aktive të tjera afatgjata</b>	-	-	-
<b>TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)</b>	<b>11,492,363</b>	<b>10,801,624</b>	<b>690,739</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE (I + II)</b>	<b>18,429,105</b>	<b>12,669,822</b>	<b>5,759,283</b>

**Pasqyrat Financiare**
**PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË**
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013(vazhdim)**
**(Të gjitha balancat janë në lekë)**

B	PASIVI	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2013	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2012	Ndryshimi
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>				
<b>I</b>	<b>DETYRIMET AFATSHKURTRA</b>			
1	Derivativët	-	-	-
2	Huamarrjet			
	(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra	9,418,581	-	9,418,581
	(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata	-	-	-
	(iii) Bono të konvertueshme	-	-	-
	<b>Totali 2</b>	<b>9,418,581</b>	<b>-</b>	<b>9,418,581</b>
3	Huatë dhe parapagimet			
	(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	110,374,089	-	110,374,089
	(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	(904,920)	-	(904,920)
	(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore	985,249	51,656	933,593
	(iv) Hua të tjera	-	724,140	(724,140)
	(v) Parapagimet e arkëtuara	-	-	-
	<b>Totali 3</b>	<b>110,454,418</b>	<b>775,796</b>	<b>109,678,622</b>
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra	-	-	-
5	Provizionet afatshkurtra	-	-	-
	<b>TOTALI I DETYR. AFATSHKURTRA (I)</b>	<b>119,872,999</b>	<b>775,796</b>	<b>119,097,203</b>
<b>II</b>	<b>DETYRIME AFATGJATA</b>			
1	Huatë afatgjata			
	(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja fir	-	-	-
	(ii) Bonot e konvertueshme	-	-	-
	<b>Totali 1</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
2	Huamarrje të tjera afatgjata	-	-	-
3	Provizionet afatgjata	-	-	-
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra	-	-	-
	<b>TOTALI I DETYR. AFATGJATA (II)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>	<b>119,872,999</b>	<b>775,796</b>	<b>119,097,203</b>
<b>III</b>	<b>KAPITALI</b>			
1	Aksionet e pakicës ( përdoret vetëm në r	-	-	-
2	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqë	-	-	-
3	Kapitali i regjistruar(aksionar)	26,854,184	26,854,184	-
4	Primi i aksionit	-	-	-
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)	-	-	-
6	Rezerva statutore	-	-	-
7	Rezerva ligjore	-	-	-
8	Rezerva të tjera	-	-	-
9	Fitimet(humbja) e pashpërndara	(15,368,581)	(10,401,751)	(4,966,830)
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	(112,929,497)	(4,966,830)	(107,962,667)
	<b>TOTALI I KAPITALIT (III)</b>	<b>(101,443,894)</b>	<b>11,485,603</b>	<b>(112,929,497)</b>
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT (I,II)</b>	<b>18,429,105</b>	<b>12,261,399</b>	<b>6,167,706</b>

**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013**  
 (Të gjitha balancat janë në lekë)

**PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË**

	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2013	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2012	Ndryshimi
2 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	158,893,295	85,901,835	72,991,460
3 Te ardhura te shtyra( rimarje gjoba me vendimgjyl	-	-	-
4 Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme	-	-	-
5 Materialet dhe mallrat e konsumuara	(44,220,981)	(7,137,534)	(37,083,447)
6 Kosto e punës			
Pagat e personelit	(27,007,623)	(13,547,791)	(13,459,832)
te tjera personeli	-	-	-
Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndet:	(3,472,574)	(2,095,197)	(1,377,377)
6 Amortizimet dhe zhvlerësimet	(270,217)	(4,386,455)	4,116,238
7 Shpenzime të tjera	(196,304,762)	(63,614,677)	(132,690,085)
8 Shpenzime të panjohura	-	-	-
<b>9 Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)</b>	<b>(271,276,157)</b>	<b>(90,781,654)</b>	<b>(180,494,503)</b>
<b>10 Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1-</b>	<b>(112,382,862)</b>	<b>(4,879,819)</b>	<b>(107,503,043)</b>
10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësit	-	-	-
11 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesë	-	-	-
12 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare			
12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata	-	-	-
12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 7€	(465,104)	(87,010)	(378,094)
12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 6€	(81,531)	-	(81,531)
12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	-	-	-
<b>13 Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financia</b>	<b>(546,635)</b>	<b>(87,010)</b>	<b>(459,625)</b>
<b>14 Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)</b>	<b>(112,929,497)</b>	<b>(4,966,829)</b>	<b>(107,962,668)</b>
<b>15 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69</b>			<b>-</b>
<b>16 Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)</b>	<b>(112,929,497)</b>	<b>(4,966,829)</b>	<b>(107,962,668)</b>

**Shënime plotësuese në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare  
Të Partisë Socialiste të Shqipërisë për periudhën Janar – Dhjetor 2013  
(Të gjitha balancat janë në lekë).**

---

**1. INFORMACIONE TË PËRGJITHESHME**

**Baza ligjore për kryerjen e këtij misioni:**

- Ligji Nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin Nr. 10374, datë 10.02.2011.
- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”
- Vendimi Nr.15, datë 02.05.2014 i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.
- Çdo dokument ligjor i marrë pranë Partisë Socialiste të Shqipërisë.

**2. TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR**

Sipas dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se Partia Socialiste e Shqipërisë (me initiale PS ose PSSH), është regjistruar më datë 12.06.1991. Veprimtaria e PS rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin Nr. 10374, datë 10.02.2011, Ligjit Nr. 8788, datë 07.01.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, Ligjit Nr. 8779, datë 07.05.2011 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, si edhe statuti i saj.

**Qëllimi i krijimit:**

Qëllimi dhe objektivat e Partisë Socialiste të Shqipërisë janë të përcaktuara në programin dhe Statutin e saj.

**Organizimi dhe drejtimi**

Instancat dhe organet qendrore të PSSH janë:

- Kongresi i Partisë
- Asambleja Kombëtare (AK)
- Kryesia e Partisë
- Kryetari i Partise
- Sekretariati Ekzekutiv i Partisë Socialiste.

Organet drejtuse të partisë në rrethe janë:

- Këshilli i Koordinuar i Partisë në Qark
- Asambleja Socialiste e Rrethit
- Kryetari i Partisë i Rrethit
- Asambleja Socialiste e Bashkisë/Komunës
- Kryetari i Partisë i AS të Bashkisë/Komunës

Kryetari është Z. Edi RAMA i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të Partisë Socialiste të Shqipërisë.



### **Burimet e financimit të PS janë:**

- Të ardhura nga kuatat e antarësisë
- Të ardhura nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike.
- Nga ndihmat e antareve dhe përkrahësve të partisë
- Të ardhura të tjera në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL**

Në statutin e PS përcaktohen rregullat për përdorimin e burimeve financiare e materiale dhe kontrollin e tyre si më poshtë:

1. Rezultati financiar dhe buxheti vjetor i Partisë në shkallë vendi, shqyrtohet dhe miratohet në kryesinë e PSSH.
2. Për drejtimin dhe koordinimin e veprimtarisë financiare të partisë si dhe kontrollin mbi administrimin e tyre në të gjitha nivelet e strukturave të partisë funksionojnë financierët e Partisë dhe komisionet e revizorëve të emëruar sipas kritereve të përcaktuara në këtë Statut.
3. Veprimtaria ekonomike e financiare e Partisë shtrohet për shqyrtim në mbledhjen e parë të vitit të AK të PS, dhe më shumë se njëherë në vit në kryesinë e Partisë.
4. Strukturat organizative të Partisë detyrohen ti përmbahen planit ekonomik dhe financiar.
5. PS respekton detyrimet financiare të pësmarrjes së saj në organizmat partiake ndërkombëtare.
6. Rezultatet financiare dhe buxheti vjetor i partisë në shkallë rrethi, bashkie/komune shqyrtohet në AS përkatëse. AS e rrethit, bashki/komunë ka iniciativë në përdorimin e buxhetit të saj në zbatim të planit financiar për zgjidhjen e problemeve administrative dhe në gjetjen e burimeve të ligjeshme të të ardhurave.
7. Përdorimi i burimeve të paligjshme për financimin e veprimtarisë së partisë ose në emër të saj dhe përdorimi për qellime personale i burimeve materiale dhe financiare të partisë është i papajtueshëm me normat morale dhe organizative të PS. Sipas shkalles së përgjegjësisë për shkëlqjen e kësaj disipline ndaj antarit të partisë merren masat përkatëse.
8. Masat jepen përkatësisht nga AS e rrethit, Bashkisë/Komunës dhe Kryesia e PS.
9. Detyrat e kryefinancierit, të financierëve dhe të Komisionit të Revizorëve në qëndër e në nivel vendor përcaktohen me rregullore të veçantë që miratohet nga Asambleja Kombëtare e PS.

### **Mënyra e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe planin Unik Kontabël, të miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave.

Kërkesat për arketim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara nga klientët apo të dokumentave të tjera kontabël.

Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentave origjinale kontabël.

Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga donatorët dhe përdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financiar.

Drejtimi financiar ka përdorur si monedhë bazë raportimi monedhën kombëtare Lekë. Fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera janë mbartur në dokumentacionin fillestar në monedhat: Lekë, USD dhe Euro ose në kontributë në natyrë. Fondet dhe shpenzimet e emetuara në monedha të huaja janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të datës që është kryer transaksioni, dhe donacionet në natyrë janë vlerësuar në lekë me çmimin e tregut në momentin e përfitimit.

Partia është e përjashtuar nga taksat mbi fitimin. Ndërsa detyrimet në lidhje me Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore dhe Tatimin mbi të Ardhurat Personale janë shlyer konform legjislacionit në fuqi.

### **Organizimi i Kontabilitetit.**

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Partia ka ndërtuar një plan të llogarive vetjake në përputhje të plotë me planin Unik Kontabël. Kontrolli i brëndshëm kryhet nga dega e financës. Kontabiliteti mbahet në program financiar, (ALFA).

### **Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)**

Gjëndjet e mjetet monetare në bankë dhe arkë, në lekë dhe në monedhë te huaj, në datat 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarise	Gjendja ne 31.12.2013		Ija ne 31.12.2012		Ndryshimi
	Monedha	Ne leke	Monedha	Ne leke	
LLOGARI BANKARE		(9,418,581)	-	512,019	(9,930,600)
Banka credins ne leke		(9,452,830)		463,130	(9,915,960)
BKT ne leke		28,152		48,736	(20,584)
Banka credins ne EURO	41.27	5,758		-	5,758
Banka credins ne usd	3.2	339		153	186
Arka ne leke	LEK	1,691,970		682,226	1,009,744
<b>Shuma</b>		<b>1,691,970</b>		<b>1,194,245</b>	<b>497,725</b>

Gjëndjet e llogarive të likujditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e llogarive rrjedhëse dhe konfirmohen nga nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të bankës respektive. Gjendja Kreditore e Bankave është pasqyruar në total në pasiv te bilancit ne postin huamarrje afat shkurtër (Overdraft).

### **Aktive të tjera financiare afatshkurtra**

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ndryshimi
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	1,090,000	-	1,090,000
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	109,309	-	109,309
(iii) Instrumente të tjera borxhi	2,624,720	-	2,624,720
(iv) Investime të tjera financiare	-	-	-
<b>Shuma</b>	<b>3,824,029</b>	<b>-</b>	<b>3,824,029</b>

(i) “Llogari / Kërkesa të arkëtueshme” në shumën 1 090 000 lekë janë pasqyruar faturat e paarkëtuara për qiradhënie ambjenti, të cilët pasqyrohen si më poshtë:

I. ORD Dajti	340 000 lekë
II. Alfa Zeta	750 000 lekë
<b>Gjithsej</b>	<b>1 090 000 lekë</b>

(ii) Kërkesa të tjera të arkëtueshme në shumën 109 309 lekë përfaqësojnë detyrimet e shtetit ndaj entitetit për TVSH për tu rregulluar e cila është pasqyruar si TVSH e kreditushme.

Shumat e paraqitura në (iii) “instrumeta të tjera borxhi janë paradhënie personeli në shumën 2 624 720 lekë.

### **Inventari**

Gjëndjet e inventarit në fillim dhe fund të ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ndryshimi
<b>Inventari</b>			
Artikuj inventar ne magazine	1,420,743	673,953	746,790
<b>Shuma</b>	<b>1,420,743</b>	<b>673,953</b>	<b>746,790</b>

Inventari përbehet nga vlera kancelari e të tjera gjendje në magazinë.

### **Aktivet Afatgjata Materiale (AAM-të)**

Gjëndjet dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Ndertime e Rikonstruksione	Mjete trasporti	Aktivet te tjera afatgjata materiale	pajise Zyre dhe ifomatike	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2013	1,643,389	5,737,540	7,589,730	578,376	15,549,035
Shtesat	-	-	960,956	-	960,956
Pakesimet	-	-	-	-	-
<b>Kosto e AAM-ve 31.12.2013</b>	<b>1,643,389</b>	<b>5,737,540</b>	<b>8,550,686</b>	<b>578,376</b>	<b>16,509,991</b>
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2013	-	4,386,455	-	360,956	4,747,411
Amortizimi ushtrimit	-	270,217	-	-	270,217
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-
<b>Amortizimi i AAM-ve 31.12.2013</b>	<b>-</b>	<b>4,656,672</b>	<b>-</b>	<b>360,956</b>	<b>5,017,628</b>
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2013	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
<b>Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2013</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2013	1,643,389	1,351,085	7,589,730	217,420	10,801,624
<b>Vlera neto e AAM-ve 31.12.2013</b>	<b>1,643,389</b>	<b>1,080,868</b>	<b>8,550,686</b>	<b>217,420</b>	<b>11,492,363</b>

Subjekti ka kryer inventarin me 31.12.2013 me procedure inventarizimi.

### **Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet**

Huatë dhe parapagimet afateshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2013 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ndryshimi
Huamarrjet			
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra ( Overc	9,418,581	-	9,418,581
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata	-	-	-
(iii) Bono të konvertueshme	-	-	-
<b>Shuma</b>	<b>9,418,581</b>	<b>-</b>	<b>9,418,581</b>

“Huatë afat shkurtër” në shumën 9 418 581 lekë përfaqesojnë overdraft të marrë nga entiteti pranë Bankës Credins.

### **Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet**

Huatë dhe parapagimet afateshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2013 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ndryshimi
Huatë dhe parapagimet			
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	110,306,616		110,306,616
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	(904,920)	408,423	(1,313,343)
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqërore	985,250	775,796	209,454
(iv) Hua të tjera			-
(v) Parapagimet e arkëtuara		-	-
<b>Shuma</b>	<b>110,386,946</b>	<b>1,184,219</b>	<b>109,202,727</b>

(i) “Të pagueshme ndaj furnitorëve” në shumën 110 306 616 lekë pasqyrojnë detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve gjëndje pa u likuiduar në fund të ushtrimit përgatitur inventarët kontabël dhe shuma e llogarisë sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor. Lista e Furnitorëve të palikuiduar më 31.12.2013 ndodhet në entitet.

(ii) “Të pagueshme ndaj punonjësve” në pasqyrat financiare paraqiten në shumën 904 920 lekë, përfaqëson paradhënie pagash personeli.

(iii) “Detyrimet tatimore+sig.shoqërore” përfaqësojnë detyrimin për sigurimet shoqërore e shëndetësore të muajit Dhjetor 2013 në shumën 480 260 lekë. TAP të muajit dhjetor 2013 në shumën 84 593 lekë dhe tatim në burim në shumën 420 397 lekë.

### **Fondet e veta**

Fondet e veta të Partisë pasqyrohen si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ndryshimi
<b>Fondet Baze</b>	26,854,184	26,854,184	-
Teprica e Fondeve të vitit kaluar	(15,368,581)	(10,401,751)	(4,966,830)
Teprica (mungesa) e Fondeve të vitit	(112,862,025)	(4,966,830)	(107,895,195)
Te ardhurat të tjera			-
<b>Shuma</b>	<b>(101,376,422)</b>	<b>11,485,603</b>	<b>(112,862,025)</b>

## Fitimi (humbja) e vitit financiar

### ▪ Të Ardhurat

Partia Socialiste e Shqipërisë gjatë vitit 2013 ka realizuar të ardhura si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ndryshimi
<b>Te ardhurat</b>			
Te ardhurat Fonde KQZ ( Buxheti I Shtetit) buxheti	98,901,659	75,283,434	23,618,225
Te ardhurat nga Kuata Antaresimi	55,117,019	350,000	54,767,019
Te ardhurat nga Kuata Deputeteve		3,492,000	(3,492,000)
Te ardhurat nga Donacione private		1,675,000	(1,675,000)
Te ardhurat nga Qerate	4,873,576	5,100,000	(226,424)
Te ardhurat te tjera		14,000	(14,000.00)
<b>Shuma</b>	<b>158,892,254</b>	<b>85,914,434</b>	<b>72,977,820</b>

Nga auditimi rezultoi se Të ardhurat e siguruara nga Partia Socialiste për vitin kalendarik 2013 janë deklaruar gjithsej 158 892 254 lekë. Këto të ardhura janë krijuar nga tre burime të ligjshme dhe konkretisht:

- Financimi nga buxheti i shtetit në shumën 98 901 659 lekë ose 63.34 % të totalit të fondeve të përdorura për vitin 2013. Nga këto:
  - Për fushatën elektorale janë xhiruar nga buxheti i shtetit 26 114 596 lekë
  - Fonde vjetore në 72 787 063 lekë
- Fondet e vetë Partisë Socialiste në shumën 55 117 019 lekë ose 34.70 % të totalit të fondeve të përdorura për vitin 2013. Fondet e veta paraqiten si më poshtë:
  - Kuata Antarësimi në shumën 14 712 900 lekë
  - Sponsorizime për fushatën zgjedhore në shumën 40 404 119 lekë

Nga verifikimet rezultoi se të gjithë dhuruesit kanë nënshkruar deklaratën e mospasjes konflikt interesi në përputhje me nenin 89 të ligjit Nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Të gjithë këta dhurues janë evidentuar dhe deklaruar në regjistrin e posacëm të mbajtur sipas formatit të miratuar me vendim Nr. 226 datë 01.06.2009 nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Në të gjitha rastet dhuruesit kanë respektuar kërkesën ligjore të Kodit Zgjedhor sipas së cilës dhurata nuk mund të jetë më shumë se 1 000 000 lekë për cdo rast. Po ashtu nga verifikimi rezultoi se të gjitha këto dhurime janë kryer nëpërmjet llogarisë bankare 00000288405 llogari e posacme e çelur për fushatën elektorale të 23 Qershor 2013 nga Partia Socialiste pranë Bankës Credins dhe BKT në llogarinë Bankare 401273430 si dhe deklaruar brenda afatit.

- Të ardhura nga qiradhëniet në shumën 4 873 576 lekë

### ▪ Shpenzimet e veprimtarisë kryesore

Konsumi i materialeve, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumat e paguara ose të pagueshme. Kostoja e punësimit, pagë dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar.

Tabela e mëposhtme paraqet një detajim të shpenzimeve të tjera.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ndryshimi
<b>Shpenzime te tjera</b>			
Energji elektrike	1,357,398	1,389,901	(32,503)
Shpenzim telekomi	5,887,347	5,932,683	(45,336)
Udhetim e dieta	7,208,054	9,797,859	(2,589,805)
Qera Ambjenti	4,910,000	6,281,937	(1,371,937)
Reklama	157,247,683	5,025,337	152,222,346
Kanceleri etj.	1,421,129	1,469,206	(48,077)
Kuota antaresimi PS ne europe	689,500	659,598	29,902
Konsulenca	4,566,398	2,176,775	2,389,623
Abonime		510,200	(510,200)
Ndime e zonave malore		1,365,360	(1,365,360)
Te tjera Shpenzime	13,009,199	28,678,480	(15,669,281)
<b>Shuma</b>	<b>196,296,708</b>	<b>63,287,336</b>	<b>133,009,372</b>

▪ **Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare janë paraqitur si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ndryshimi
Komisione dhe interesat bankare	(466,499)	(93,714)	(372,785)
Te ardhura nga interesat bankare	1,396	6,704	(5,308)
Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)	63,360		63,360
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	(144,892)		(144,892)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668			-
			-
<b>Shuma</b>	<b>(546,635)</b>	<b>(87,010)</b>	<b>(459,625)</b>

▪ **Shpenzime personeli**

Numri mesatar i punonjësve dhe pagat janë si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Numri mesatar i te punesuarve	28
Shpenzime page	(21,534,081)
Shpenzime sigurime shoq. dhe shendetsore	(3,472,574)
Te Tjera shpenzime prsoneli	(5,473,542)
<b>Shuma</b>	<b>(30,480,197)</b>

**Eksperte Kontabël e Regjistruar**

Margarita Kalemasi

